

# **XXI MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE DHE TRANSPARENCA PËR TË DHËNAT PUBLIKE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM**

## **NOCIONET KRYESORE:**

Të dhënat personale; koleksionet e të dhënave; përdoruesi me përmbledhjet e të dhënave; shfrytëzuesi i të dhënave; mbikqyrja; mbrojtja gjyqësore; qasje e lirë deri tek informacionet; parimi i transparencës.

## **PYETJE:**

1. A e garanton Kushtetuta e RM-së të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale?
2. Cili është qëllimi i mbrojtjes ligjore të të dhënave personale?
3. Ç'janë të dhënat personale?
4. Ç'është përmbledhje e të dhënave?
5. A mundet që me urdhër të Qeverisë së RM-së të krijohet përmbledhje e të dhënave që ka të dhëna personale?
6. Për çfarë qëllimesh mund të shfrytëzohet përmbledhja e të dhënave?
7. Kush mund të jetë shfrytëzues i të dhënave?
8. Çfarë të drejtash ka personi për të cilin kan të bëjnë të dhënat në raport me përdoruesin e përmbledhjeve të të dhënave?
9. A mund të kufizohet e drejta e personit në lidhje me të dhënat personale?
10. A është e lejuar bartja e të dhënave personale jashtë RM-së?
11. Cili parim për veprimtarinë e organeve të pushtetit ekzekutiv përfshin rregullimin e qasjes së lirë ndaj informacioneve?
12. A ekziston në RM detyrimi për organet e administratës shtetërore dhe Qeverinë që ta informojnë publikun për veprimtarinë e saj?

## 1. Mbrojtja e të dhënave personale

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e garanton siguritë dhe fshehtësinë e të dhënave personale.<sup>1</sup> Me Kushtetutë qytetarëve u garantohet edhe mbrojtja nga cënimi i integritetit personal që del nga regjistrimi i informacioneve për ta, nëpërmjet përpunimit të të dhënave. E drejta e mbrojtjes së të dhënave është një nga të drejtat civile dhe politike të njeriut dhe qytetarit.

Organet e pushtetit shtetëror, në shumicën e rasteve, paraqiten në cilësinë e organit në të cilin të dhënat grumbullohen, evidentohen, përpunohen dhe shfrytëzojnë shumicën e të dhënave të qytetarëve. Kjo ndodh sidomos me organet e administratës shtetërore, të cilat gjatë vëzhgimit të situatave në territoret për të cilat janë krijuar, mbajnë evidencë dhe regjistra të ndryshëm që kanë të bëjnë pjesërisht ose plotësisht me të dhënat e qytetarëve ( p.sh., evidencat amë të të lindurve, të martuarve, të vdekurve, dhe evidencat për obliguesit tatimore, etj ). Megjithatë, edhe organet e tjera shtetërore, gjykatat dhe personat të e juridikë të autorizuar me ligj, mbajnë evidenca dhe koleksione të të dhënave të llojllojshme në të cilat përfshihen të dhënat personale të qytetarëve ( Regjistri qëndror, evidencat në fushën e punës, shëndetësisë, mrojtjen sociale, evidencat personale e tj.). Duke u nisur nga kjo, mbrojtja e të dhënave personale e qytetarëve, si e drejtë kushtetuese e garantuar, shfaqet si një çështje e rëndësishme në lidhje me veprimtarinë e përditshme të një numri të madh organesh të sektorit publik.

Mbrojtja e të drejtës kushtetuese të garantuar të sigurisë dhe fshehtësisë së të dhënave personale detajisht është përpunuar me ligj.<sup>2</sup> Mbrojtja ligjore e të dhënave personale shtrihet edhe në rastet kur përpos organeve shtetërore dhe personave të tjerë juridikë, fizikë ose individualë në ushtrimin e profesionit ose veprimtarisë së pavarur paraqiten në cilësinë e përdoruesve me përmbledhje të të dhënave mbi bazë të autorizimit ligjor ose pëlqimit me shkrim të personit për të cilin kanë të bëjnë të dhënat.

Synimi i mbrojtjes së të dhënave personale është që të sigurohet intimiteti dhe fshehtësia e të dhënave që kanë të bëjnë me personat fizikë, ndërsa janë objekt i mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, shfrytëzimit dhe ndërrimit të të dhënave në formë të përmbledhjeve me dorë të të dhënave. Me të *dhëna personale* kuptohet çdo e dhënë që ka të bëjë me cilindo person fizik.

*Përmbledhje e të dhënave* janë të dhëna të shumta të organizuara të cilat plotësisht ose pjesërisht përmbajnë të dhëna personale ( regjistra, evidenca, bazat e të dhënave dhe të ngjashme.) të cilat regjistrohen dhe shfrytëzohen me dorë ose me mjete për përpunimin automatik të të dhënave.

Mbrojtja e të dhënave personale realizohet përmes trajtimit dhe masave ligjore, organizative dhe teknologjike me anë të të cilave pengohet:

- grumbullimi, përpunimi, ruajtja, shfrytëzimi ose bartja e paligjshme e të dhënave;
- qasja e paligjshme deri tek të dhënat ose mjetet ku ruhen të dhënat;
- asgjësimi i rastësishëm ose me qëllim i të dhënave; dhe

<sup>1</sup> Neni 18 i Kushtetutës së RM-së.

<sup>2</sup> Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale „ Gazeta zyrtare e RM-së ” nr. 12/94.

- bartja ose nxjerrja e të dhënave jashtë Republikës së Maqedonisë në mënyrë të paligjshme.

Në pjesën e mbrojtjes ligjore të të dhënave personale janë normuar më shumë marrëdhënie, procedime dhe masa. Para se gjithash, përmbledhjet që përfshin të dhëna personale mund të vendosen, evidentohen dhe të mbahen vetëm në bazë të ligjit ose në bazë të pëlqimit me shkrim nga personi për të cilin kanë të bëjnë të dhënat.

Përmbledhjen e të dhënave e vendosin, mbajnë, shfrytëzojnë *përdoruesit me të dhëna* që mund të jenë persona juridikë dhe fizikë ose individualë në ushtrimin e pavarur të veprimtarisë ose profesionit të *autroizuar me ligj ose mbi bazën e pëlqimit me shkrim nga personi për të cilin kanë të bëjnë të dhënat*. Përdoruesit me të dhëna disa veprime të caktuara në lidhje me grumbullimin, përpunimin, ruajtjen, shfrytëzimin dhe dorëzimin e të dhënave mund t'ia transferojnë *kryerësit të kontraktuar* – personit juridik ose individual në ushtrimin e pavarur të veprimtarisë ose profesionit ose personit fizik të autorizuar për ushtrimin e veprimtarisë së këtillë.

Disponuesi me të dhëna personale mund t'i grumbullojë, përpunojë, ruajë, shfrytëzojë dhe dorëzojë vetëm për qëllime të caktuara me ligj ose për *qëllime që dalin nga pëlqimi me shkrim i personit* për të cilin kanë të bëjnë të dhënat, e kurrsesi t'i shfrytëzojë në kundërshtim me qëllimet ligjore.

Dipsonuesi me të dhëna mund t'i dorëzojë të dhëna personale vetëm *shfrytëzuesit* i cili është i autorizuar me ligj për shfrytëzimin e tyre, ose në bazë të kërkesës me shkrim ose të pëlqimit me shkrim të personit ose i autorizuari i tij. Shfrytëzuesi i të dhënave, të dhënat e fitura mund t'i shfrytëzojë vetëm në mënyrën që është në pajtim me ligjin.

Të dhënat personale që shfrytëzuesi i përdor për qëllime të hulumtimeve shkencore, edukative ose për qëllime të tjera të ngjashme, disponuesi me përmbledhje të të dhënave është i detyruar t'i dorëzojë në mënyrën dhe formën të cilat nuk mundësojnë identifikimin e personit.

Me veprimet dhe masat teknologjike të organizuara që ndërmerren për shkak të mbrojtjes së të dhënave personale:

- sigurohen hapësirat, pajisjet dhe programet me anë të së cilave përpunohen të dhënat personale;
- garanton tohet dorëzimi dhe bartja e të dhënave personale dhe
- pamundësohet qasja e paautorizuar deri tek pajisjet dhe programet me anë të së cilave përpunohen të dhënat personale dhe përmbledhjet që përmbajnë të dhëna personale.

Kontrollin mbi ligjshmërinë e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, shfrytëzimit dhe dorëzimit të të dhënave personale, si dhe mbi nxjerrjen jashtë Republikës së Maqedonisë, e ushtron organi i përcaktuar me ligjin me të cilin krijohet përmbledhja. Kontrollin inspektues mbi implementimin e masave dhe aktiviteteve teknologjike dhe organizative e ushtron organi kompetent i administratës për veprimtaritë e informatikës dhe për sistemin informativ të Republikës së Maqedonisë ( Ministria e Arsimit dhe Shkencës ). Për shembull, sipas Ligjit për mbajtjen e rregjistrave në Republikën e Maqedonisë, Ministria e Financave ushtron kontroll mbi zbatimin e ligjit,

ndërsa Ministria e Arsimit mbi inplimentimin e masave organizative dhe teknologjike dhe të procedurave për mbrojtjen e të dhënave.

Personi për të cilin kanë të bëjnë të dhënat ka të drejtë, nga përdoruesi me përmbledhje të të dhënave, pas kërkesës së tij me shkrim ose pas kërkesës me shkrim nga personi i autorizuar prej tij:

- të kërkojë që t'i mundësohet shqyrtimi i të dhënave që kanë të bëjnë me të dhe t'i jepet ekstrakt nga të dhënat përkatëse;
- të kërkojë që të dhënat të plotësohen, përmirësohen ose të fshihen, për të cilat ai do të vërtetojë se janë jo të plota, jo të sakta jo të azhuruara ( me ç'rast vetë plotësimi, përmirësimi ose fshirja e të dhënave nuk i liron disponuesin me përmbledhje të të dhënave dhe personin përgjegjës nga përgjegjësia e mundshme kundravajtëse, penale ose materiale );
- në çdo moment ta tërheq pëlqimin, në qoftë se përmbledhja është vendosur mbi bazën e pëlqimit me shkrim dhe të kërkojë që të dhënat që kanë të bëjnë me të të fshihen nga përmbledhja.

Të drejtat e personit në lidhje me të dhënat personale mund të kufizohen me përjashtim, në rastet e caktuara me ligj dhe në rastet që janë të domosdoshme për realizimin e sigurisë dhe mbrojtje së RM-së ??, ndërmarjen e procedurës penale, mbrojtjen e interesave ekonomike të RM-së, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve ose ambientit jetësor. Të drejtat e personit në lidhje me të dhënat personale nuk kanë të bëjnë me të dhënat që mbledhen për qëllime statistike.

Personi ka të drejtë në *mbrojtjen gjyqësore* kur do të vlerësojë se janë shkelur të drejtat e tij në lidhje me të dhënat personale, si dhe e *drejta e dëmshpërblimit*, në qoftë se për shkak të shfrytëzimit të të dhënave në mënyrë ose për qëllime që nuk janë në pajtim me ligjin personit i është shkaktuar dëmi.

Nxjerrja e të dhënave personale dhe dorëzimi i shfrytëzuesve jashtë RM-së nuk është e lejueshme, përveç në dy raste: (1) kur me ligj me të cilin është rregulluar përmbledhja e të dhënave është vendosur ndryshe dhe (2) kur për këtë ekziston pëlqim me shkrim nga personi për të cilin kanë të bëjnë të dhënat. Në këto raste, të dhënat e shfrytëzuesve mund të dorëzohen jashtë RM-së mbi bazën e parimit të reciprocitetit dhe mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare, ose bashkëpunimit në fushën e afarizmit, teknikës, teknologjisë, kulturës, ose mbi bazë të ndonjë bashkëpunimi tjetër.

## 2. Tranzparenca e të dhënave me interes publik

Problemi i mbrojtjes së të dhënave personale dhe rregullimi i qasjes deri te këto të dhëna nga ana e qytetarëve për të cilët kanë të bëjnë ato është një nga elementet të cilat në shumë vende të botës trajtohen në legjislacion si të ashtuquajtura *qasje e lirë deri te informacionet*, qëllimi kryesor i së cilës është mbrojtja e të drejtave dhe lirive njerëzore, pjesëmarrja e qytetarëve në mbrojtjen dhe promovimin e tyre, sigurimi i zbatimit të parimit të ligjshmërisë dhe transparencës në veprimtarinë e organeve të pushtetit.

Ideja e qasjes së lirë ndaj informacioneve ( *freedom of information* ) e cila zanafillën e saj e ka në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sot është pranuar në Kanada, Australi, Zelanda e Re, Irlanda, Danimark, vendet skandinave dhe në vende të tjera të Bashkimit

Evropian në formë të rregullativës adekuate ( më së shumti si ligji për qasjen e lirë ndaj informacioneve “ *Freedom of information Act* ”). Edhe pse vëllimi dhe garancitë procedurale të së drejtës së qasjes ndaj informacioneve zyrtare në administratën publike janë të ndryshme, në legjislacionet e këtyre vendeve, në esencë ato bazohen në idenë e operacionalizimit të parimit të transparencës së veprimtarisë së organeve të pushtetit ekzekutiv, pushtetit vendor dhe institucioneve publike të tjera dhe të personave juridikë që kryejnë autorizime publike. Nisur nga kjo, çdo individ i sigurohet e drejta e qasjes jo vetëm ndaj informacioneve dhe të dhënave personale që kanë të bëjnë me të, por edhe e drejta e qasjes ndaj të gjitha informacioneve zyrtare që gjenden në këto organe ( në formë të dokumenteve të shkruara ose elektronike, fotografi, harta, plane, mikrofilma, materiale audio-vizuele etj. ), e që janë me interes për publikun. Si përjashtim, nuk është e lejueshme qasja ndaj informacioneve që janë të karakterit të besueshëm, për mes të cilit çenohet e drejta e fshehtësisë dhe privatësisë? së të dhënave personale të personave të tjerë fizikë, ëq janë me përmbrojtje për sigurinë e vendit të politikës së jashtme ose, përsëri kanë të bëjnë me rregulla interne kadrovike, praktika dhe shkresa interne ndërmjet organeve.

Rezultatet praktike pozitive nga zbatimi i rregullativës për qasjen e lirë ndaj informacioneve në vendet ku ajo zbatohet janë parë si në segmentet e veçanta të përmirësimit të procesit të vendimarrjes ( gjat këtij kontrolli të institucionalizuar mbi veprimtarinë e tyre nga ana e publikut, organet janë të detyruara që në mënyrë cilësore t’i arsyetojnë vendimet e veta ), përmirësimin e besimit të publikut dhe të klientëve, deri tek rezultatet më të mira në veprimtarinë arkivore dhe menaxhimin e sistemeve informative.

Në ligjet e Republikës së Maqedonisë përmes së cilave rregullohet veprimtaria e Qeverisë dhe e organeve të administratës shtetërore, ekzistojnë rregulla për mes së cilave konstatohet detyrimi për Qeverinë edhe për organet e administratës shtetërore që ta informojnë publikun për veprimtarinë e vetë.<sup>3</sup> Për pos realizimit të këtij detyrimi në formë të njoftimit zyrtar të publikut nga ana e personave zyrtarë dhe organeve në Qeveri, organeve të administratës shtetërore, si dhe informimi i publikut në mënyra të tjera dhe me mjete të tjera për komunikim, duket se aprovimi i rregullave ligjore plotësuese në Republikën e Maqedonisë për të drejtën e qasjes së qytetarëve ndaj informacioneve në bazë të vetiniciativës do të kontribuonte për realizimin më përfshirës dhe më efikas të parimit të transparencës në veprimtarinë e organeve shtetërore, në funksion të realizimit më efikas të parimit të ligjshmërisë dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive njerëzore.

---

<sup>3</sup> Neni 7 i Ligjit për Qeverinë e RM-së ( „ Gazeta zyrtare e RM-së “ nr. 59/2000 ) dhe neni 9 i Ligjit për organizimin dhe veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore ( „ Gazeta zyrtare e RM-së “ nr. 58/2000 ).